



VENDIM
Nr. 69 Datë 11.05.2017

MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SH.A., NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2017, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. për rinovimin e licencës, në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

1. Shoqëria “Kurum International” sh.a., me shkresën nr. 31 Prot., datë 06.04.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për rinovimin e licencës së furnizimit me energji elektrike.
2. Shoqëria Hec “Ulëz - Shkopet” sh.a është pajisur me licencën e furnizuesit të kualifikuar me Vendimin nr. 106, datë 20.07.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE dhe Shoqëria Hec “Bistrica 1” sh.a, “Bistrica 2” sh.a me Vendimin nr. 110, datë 31.07.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE. Afati për të dy këto licenca përfundon respektivisht në datat 20.07.2017 dhe 31.07.2017.
3. Bordi i Komisionerëve të ERE me Vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, ka miratuar transferimin e licencave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga shoqëritë Hec “Ulëz – Shkopet” sh.a dhe Hec “Bistrica 1”, “Bistrica 2” sh.a, tek shoqëria “Kurum International” sh.a.

4. Bordi i ERE me Vendimin nr. 98, datë 17.06.2016, “Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, ka përcaktuar se: *Efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara nga ERE në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar, shtrihen për gjithë periudhën e mbetur të kohës në licencën aktuale.*
5. Kërkesa e shoqërisë “Kurum International” sh.a për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike vjen brenda afatit të përcaktuar në nenin 16 pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për sa më sipër nga analiza që i'u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Kurum International” sh.a., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.7/1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, për një afat 5 - vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

Petrit AHMETI